REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvali - Prishtinë
Nr. / Br. 03/MG/1480/3
Data / Datum 30.10.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë

Referencë: **IPK/29102024/DI**
Datë: **29.10.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli – objekti	- Respektimi i ligjshmërisë gjatë konfiskimit të automjeteve në trafik
Referenca	- 05/2024
Data e inicimit	- 06.08.2024
Data e raportimit	- 29.10.2024
Arsyet e inicimit	- Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar fillimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar respektimin e legjislacionit në fushën e kundërvajtjeve të trafikut rrugor, gjatë konfiskimit të mjeteve me veprim motorik për shkak të ngasjes së tyre gjatë periudhës sa janë aktive masat mbrojtëse ndaj kundërvajtësve "ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik". Kërkesa për inspektim pasqyron shqetësimet e një numri ankuesish se konfiskimet e automjeteve, me të cilat janë shkaktuar kundërvajtjet, ndodhin edhe kur nuk janë pronë e kundërvajtësve. Ankesë e tillë është drejtuar edhe nga personi i autorizuar i Operatorit Ekonomik "Marketing Solutions", operator të cilit i ishte konfiskuar automjeti, për arsye se punonjësi i tij kishte drejtuar mjetin në fjalë në periudhën kur kishte qenë aktive masa mbrojtëse e ndalimit të drejtimit të mjetit motorik sipas nenit 246, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor. IPK është e interesuar të njihet me përmbushjen e kushteve për konfiskimin e mjetit dhe trajtimin e më pastajmë të ankesave nga Organi i Kundërvajtjes së shkallës së dytë (Komisioni për Vendosje).
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i respektimit të bazës ligjore nga fusha e trafikut rrugor lidhur me konfiskimin e mjeteve me veprim motorik.
Metodologjia e inspektimit	- Gjatë realizimit të punës inspektuese është aplikuar metodologjia si në vijim: (a) Janë realizuar takime - intervista me drejtues dhe bartës funksionesh, si: - Drejtorin e Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore, - Drejtorin e Divizionit të Trafikut Rrugor, dhe - Kryesuesin e Komisionit për Vendosje, (b) Janë kryer kontrolle - verifikime të rasteve me natyrë të njëjtë, (c) Janë siguruar dokumente, apo të dhëna në formë fizike - elektronike, si: - Dosje të rasteve të trajtuara nga Komisioni për Vendosje (5 sosh) dhe - Raporte periodike mbi numrin e ankesave për konfiskim të mjeteve.
Subjekti	- Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore dhe Komisioni për Vendosje.

Afatet e inspektimit	- Fillimi i inspektimit: 07.08.2024, - Përfundimi: 08.08.2024, - Periudha e mbulimit: prill - gusht 2024.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, - Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, - Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 05/2023 për procedurën e kundërvajtjes
Ekipi realizues	- Kushtrim Jonuzi, inspektor
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 29.10.2024

Shkurtesat

DPSÇL	Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
DTR	Divizioni i Trafikut Rrugor
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- *Zbatimi i nenit 246, paragrafi 6 i Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat Trafikut Rrugor ka ngritur dilemat nëse konfiskimi i përkohshëm i automjeteve është i drejtë edhe në situatat kur mjeti me të cilin shkaktohet kundërvajtja sipas paragrafit 5 të të njëjtit nen, është pronë e palëve të treta.*
- *Edhe pse Ligji aktual për fushën e trafikut është duke u zbatuar edhe në mbështetje të Ligjit për Kundërvajtje sa i përket konfiskimit të automjeteve, në mungesë të procedurave të përcaktuara me aktin nënligjor, nuk ka një qartësi të plotë se a duhet të ekzekutohet kjo masë në momentin e kundërvajtjes, apo pas marrjes së një vendimi të formës së prerë.*
- *Praktika e konfiskimit të automjeteve të palëve të treta po konsiderohet se po prekë interesat e pronarëve legjitim të tyre, me arsyetimin se ata shpesh nuk janë në dijeni që ngasësit e mjeteve të tyre i drejtojnë ato edhe përgjatë periudhës sa janë nën efektin e masës së ndalimit të drejtimit të mjetit motorik.*
- *Për të hequr dilemat mbi këto çështje të ngritura, struktura përkatëse policore duhet të adresojë kërkesat mbi marrjen e një opinioni ligjor nga autoriteti kompetent dhe nxjerrjen e aktit nënligjor që duhet të rregullojë procedurën mbi konfiskimin e automjeteve.*

Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. *IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Çështje Ligjore të Policisë së Kosovës, që të kërkojë nga Gjykata Supreme e Kosovës, nxjerrjen e opinionit ligjor mbi zbatimin e dispozitave të nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në lidhshmëri edhe me Ligjin për Kundërvajtje, i cili do të shërbejë edhe si udhëzues mbi mënyrën e drejtë të zbatimit të legjislacionit në fuqi sa i përket konfiskimit të përkohshëm të automjeteve.*
2. *IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që përmes strukturës kompetente policore, të adresojë tek Ministria kompetente, kërkesat në vazhdën e nxjerrjes së aktit nënligjor për procedurën e kundërvajtjes, të paraparë edhe me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor (neni 257), në mënyrë që akti në fjalë të rregulloj edhe procedurën e konfiskimit të automjeteve.*
3. *IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor dhe udhëheqësve të strukturave policore përgjegjëse për kontrollin dhe sigurinë e komunikacionit rrugor që në të ardhmen të shqyrtojnë mundësitë për të filluar aplikimin e praktikave për njoftimin e personave të tretë, kur automjetet e tyre janë përdorur si mjet për kryerjen e kundërvajtjeve të trafikut, në drejtim të ndërmarrjes së hapave nga ana e tyre në parandalimin e situatave që mund të rezultojnë me konfiskimin e mjeteve të tyre.*

Gjetjet kryesore:

1. Konteksti i problemit

1.1. IPK ka pasur njohuri që Komisioni për Vendosje në Policinë e Kosovës është duke pranuar numër të madh të ankesave nga palët që iu janë konfiskuar automjetet, e të cilat nuk kanë qenë pronë e tyre. Ditë më parë, edhe IPK ka pranuar një ankesë të ushtruar nga Operatori Ekonomik "Marketing Solutions", pronarit të të cilit i ishte konfiskuar automjeti, për arsye se me datën 12.07.2024, ngasësi i mjetit të tij ishte hasur duke drejtuar mjetin përgjatë periudhës sa ka qenë aktive masa mbrojtëse "ndalim i të drejtuarit të mjetit motorik", masë e cila ishte shqiptuar më parë nga Policia e Kosovës. Lidhur me këtë, IPK është njoftuar se njësia policore kompetente duke u bazuar në nenin 246, paragrafi 5 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, kishte shqiptuar sanksionin kundërvajtës, përfshirë gjobën prej 500 euro, zbatimin e masës mbrojtëse "ndalim i të drejtuarit të mjetit në periudhë 6 mujore" dhe pesë (5) pikë negative. Konform paragrafit 6 të nenit 246, kjo njësi kishte aplikuar edhe masën e konfiskimit të përkohshëm të mjetit, me të cilin ishte kryer kundërvajtja. Automjeti me të cilin ishte kryer kundërvajtja nuk ishte pronë e kundërvajtësit, por e operatorit ekonomik, ku ishte i punësuar ai si ngasës taksie.

1.2. Kundër Vendimit të organit kundërvajtës të shkallës së parë[1] (Policisë së Kosovës) për masën e konfiskimit të përkohshëm të mjetit me të cilin ishte kryer kundërvajtja, Operatori Ekonomik "Marketing Solution" (si pronar i automjetit të konfiskuar) kishte ushtruar ankesë në Komisionin për Vendosje si organ i shkallës së dytë, në procedurën për kundërvajtje, i cili autoritet ka kompetencën lëndore që të shqyrtojë dhe vendosë lidhur me kundërshtimin. Pala e pakënaqur kishte ngritur pretendimet se Policia ka të drejtë vetëm të sekuestroj veturën por jo edhe ta konfiskoj pa një aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës. Në këtë rast subjekti juridik si pronar i automjetit nuk kishte qenë në njohuri se drejtuesi i automjetit të tyre ishte nën masën mbrojtëse të ndalimit të drejtimit të automjetit. Pasi që automjeti i konfiskuar nuk ishte në pronësi të drejtuesit që ka shkaktuar kundërvajtjen, subjekti në fjalë ka konsideruar se po i shkaktohen dëme të pariparueshme për shkak të konfiskimit. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, pala ankuese kishte kërkuar lirimin e menjëhershëm të mjetit.

1.3. Komisioni për Vendosje në seancën dëgjimore të datës 23.08.2024 kishte pranuar pjesërisht të bazuar ankesën duke e ndryshuar Vendimin për Kundërvajtje në pjesën që ka të bëjë me konfiskimin e mjetit me veprim motorik, ashtu që masa e konfiskimit nuk do të ekzekutohet nën kushte të caktuara, duke liruar automjetin e konfiskuar të personit të tretë (palës ankuese), pasi të përmbushen obligimet e shkaktuara me kundërvajtjen. Sanksionin dhe masat tjera mbrojtëse ndaj personit që ka shkaktuar kundërvajtjen, Komisioni i ka lënë të pandryshuara. Në bazë të arsyetimit të Komisionit për Vendosje, Vendimi për lirim të automjetit është marrë mbi bazën e zbatimit përshtatshmërisht të legjislacionit penal të paraparë me nenin 10 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, rregullave të përgjithshme për matjen e sanksionit kundërvajtës të paraparë me nenin 31 të Ligjit dhe zbutjes së sanksionit kundërvajtës konform nenit 35 të Ligjit në fjalë.

2. Baza ligjore që rregullon konfiskimin e automjeteve në trafik

2.1. Nga muaji prill i këtij viti ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, i cili përcakton rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve në trafikun rrugor, sanksionet dhe masat kundërvajtëse ndaj palëve, të cilët sillen në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji. Neni 246 i këtij Ligji e rregullon masën mbrojtëse për patentë shofer, ku ndër të tjera në paragrafin 2 të tij ka përcaktuar që "shoferi të cilit i është marrë patenta e shoferit ose është larguar nga trafiku rrugor sipas këtij ligji, ose ndaj të cilit është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim

[1] Vendimi për Kundërvajtje nr. SHQ5A0003512001X, datë 12.07.2024.

motorik, nuk i lejohet gjatë asaj kohe të drejtojë mjetin motorik në trafikun rrugor". Kurse, në paragrafin 5 është e përcaktuar që "dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëqind (500) euro, masa mbrojtëse ndalim i drejtimit të mjetit me veprim motorik prej gjashtë (6) muaj, si dhe pesë (5) pikë negative, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni". Kurse, në paragrafin 6 është përcaktuar që "Nëse shoferi, ndaj të cilit është shqiptuar masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik, e drejton mjetin në trafikun rrugor gjatë periudhës së masës mbrojtëse, do t'i konfiskohet përkohësisht mjeti të cilin është hasur duke e drejtuar, deri sa ndaj të njëjtit është aktive masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit motorik".

2.2. Nga analiza e përmbajtjes së Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor rezulton se paragrafi 6 i nenit 246 ka paraparë konfiskimin e përkohshëm të mjetit, të cilin haset duke e drejtuar pronari i mjetit, për të cilin është aktive masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit motorik, por nuk ka ndonjë dispozitë që rregullon situatat kur kundërvajtësi nuk është pronar i mjetit me të cilin kryhet kundërvajtja. Në anën tjetër, neni 37 i Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, ka paraparë konfiskimin e sendit si lloj i masave mbrojtëse. Në nenin 38 të këtij Ligji është paraparë konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendit. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton që "sendet që janë përdorë ose kanë qenë të destinuara për kryerjen e kundërvajtjes, ose që kanë lindur me kundërvajtjen e bërë, mund të merren nëse janë pronë e kryesit të kundërvajtjes". Por, në paragrafin 2 përcaktohet që "sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren edhe kur nuk janë pronë e kryesit të kundërvajtjes ose nuk i disponon ato personi juridik, nëse këtë gjë e kërkon interesi i sigurisë së përgjithshme, ruajtja e jetës e shëndetit të njerëzve, siguria e qarkullimit të mallrave, ose arsyet e moralit publik, si dhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj".

2.3. Si rezultat i zbatimit në praktikë të nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, Policia e Kosovës si Organ i Kundërvajtës i shkallës së parë, kur hasë në ngasës që drejtojnë automjetet gjatë periudhës sa janë aktive masa e ndalimit të drejtimit të mjetit motorik, u shqipton sanksionet kundërvajtëse, aplikon masat mbrojtëse dhe realizon masën e konfiskimit të përkohshëm të mjeteve, me të cilat kryhen kundërvajtjet. Zbatimi i paragrafit 6 praktikisht për Policinë ka paraqitur sfidë për faktin se drejtuesit e mjeteve, që hasen duke i drejtuar ato gjatë periudhës sa janë nën masën mbrojtëse të ndalimit të drejtimit të mjetit motorik, shpesh automjetet me të cilat shkaktojnë kundërvajtje, nuk i kanë në pronësi të tyre, por të personave të tretë (të operatoreve ekonomik ku punojnë, të atyre që i japin me qira, etj.). Janë hasur situata kur ngasësit përdorin automjetet e operatorëve ekonomik, apo në raste të ngjashme dhe nuk i njoftojnë pronarët se iu është ndaluar drejtimi i mjeteve, si masë mbrojtëse të dhëna nga njësitë kompetente policore. Në këto raste, pronarët e automjeteve u besojnë ato personave, duke qenë të pa informuar se mund të jenë nën masën efektive të ndalimit të drejtimit të mjetit. Andaj, nisur nga këto situata dhe praktika, aplikimi i masës së konfiskimit të përkohshëm të automjeteve kur ngasësit nuk janë pronarë të tyre, prekë interesat dhe të drejtat e personave të tretë (pronarëve të mjeteve). Mbi bazën e këtyre rrethanave, me masën e konfiskimit të mjeteve, pronarët legjitim të mjeteve ndëshkohen edhe pa fajin e tyre.

2.4. Nga takimet që janë realizuar gjatë këtij inspektimi me drejtuesit e DPSÇL, DTR dhe Komisionit për Vendosje, është ngritur shqetësimi se zbatimi i paragrafit 6 të nenit 246 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor është sfidues për Policinë dhe pothuajse të gjitha rastet e aplikimit të masës së konfiskimit të përkohshëm të automjeteve nga Policia, rezultojnë me kundërshtim në Komisionin për Vendosje. Për gjetjen e një zgjidhjeje ligjore dhe në drejtim të eliminimit të dobësive dhe vështirësive që dalin gjatë zbatimit të nenit 246, paragrafit 6 të Ligjit 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, drejtuesit e Policisë së Kosovës (veçanërisht ata të DTR) kanë kërkuar inicimin e plotësim - ndryshimit të këtij Ligji, me qëllimin që dispozitat e rishikuara të determinojnë më saktë çështjet e ngritura. Në vazhdën e

	këtyre përpjekjeve, IPK është njoftuar se nga deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe anëtarë të Komisionit Parlamentar për fushën përkatëse, janë dhënë zotime se në sesionin vjeshtor do të iniciohet dhe realizohet plotësim - ndryshimi i Ligjit. 2.5. Marrë parasysh bazën ligjore në fuqi po krijohet konfuzion nëse zyrtari policor gjatë ndërmarrjes së veprimeve policore vepron drejt në marrjen e menjëhershme të automjetit si rezultat i mosrespektimit të masës aktive mbrojtëse. Kjo dilemë rrjedhë bazuar në disa fakte dhe rrethana, *së pari,* a është e drejtë të konfiskohet një automjet i personit të tretë, me të cilin është kryer kundërvajtja pa dijeninë e tij[2] dhe *së dyti,* a është e drejtë të konfiskohet automjeti para se të ndodhë një shqyrtim dhe të jetë marrë vendim i formës së prerë nga organi kompetent[3]. Duhet potencuar se nëse bazohemi përshtatshmërisht në dispozitat e KPP, në situatat kur mjeti me të cilin është kryer vepra është pronë e personit të tretë, nuk konfiskohet nëse i njëjti nuk ka dijeni lidhur me përdorimin e mjetit për kryerjen e asaj vepre. Për të shmangur paqartësitë dhe për të siguruar që konfiskimi i automjeteve që janë pronë e personave të tretë nuk cenon të drejtat e pronarëve legjitim të automjeteve, nga struktura përkatëse policore (DPSÇL) ka gatishmëri për të kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës[4], opinion ligjor, që do t'iu shërbente edhe si udhëzues mbi ligjshmërinë e zbatimit të nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor. 2.6. Neni 251, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor obligon MPB-në që në bashkëpunim me KGJK-në, që me akt nënligjor të rregullojë procedurat e veprimit nga fillimi i procedurës kundërvajtëse, deri tek nxjerrja e vendimit të plotfuqishëm dhe çështjet tjera të lidhur me të. Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2023 për Procedurat e Kundërvajtjes, nuk rregullon procedurën si duhet trajtuar konfiskimi i përkohshëm i automjeteve, meqenëse në kohën kur është nxjerrë, nuk ka qenë në fuqi Ligji që parasheh masën e konfiskimit të përkohshëm të mjeteve në trafik. Ligji aktual në nenin 257 përcakton periudhën gjashtëmujore të nxjerrjes së akteve nënligjore për zbatimin e tij. Periudha kohore në vazhdim konsiderohet koherente për të iniciuar nxjerrjen e Udhëzimit, për të kompletuar bazën ligjore, brenda së cilës do të duhej rregulluar edhe procedura e konfiskimit të automjeteve, përfshirë rrethanat, kohën dhe autoritetin vendimmarrës. 2.7. Nga mostrat e inspektuara të kundërshtimeve, pronarët legjitim të automjeteve deklarojnë se në rastet kur ndëshkohen ngasësit e mjeteve të tyre, nuk njoftohen nga rreziku i humbjes së vendit të punës dhe ndodhë që edhe kur janë nën masa aktive të ndalimit të drejtimit të mjetit, t'i drejtojnë ato duke rrezikuar edhe konfiskimin e përkohshëm të tyre. IPK është interesuar të njihet lidhur me ekzistimin e ndonjë mekanizmi njoftues, që do të mund t'i mbante të informuar pronarët e automjeteve se ngasësit e automjeteve të tyre mund të rrezikojnë konfiskimin e mjeteve nëse hasen duke i drejtuar ato nën masa aktive mbrojtëse. Nga inspektimi nuk është hasur të jetë aplikuar ndonjë praktikë e tillë dhe kjo po ua mundëson palëve ankuese në cilësi të pronarëve të automjeteve që të justifikohen se drejtimi i mjeteve të tyre në periudhat kur ngasësit janë nën masa aktive mbrojtëse, mund të ndodhë pa dijeninë e tyre, duke i bërë të prekur nga masa e konfiskimit të përkohshëm të automjeteve.

[2] Nëse i referohemi përshtatshmërisht nenit 270 të KPP (Konfiskimi i mjetit), në paragrafin 2 përcaktohet: "Nëse pasuria është mjet që i takon një pale të tretë, pasuria konfiskohet nëse: 2.1. pasuria ka qenë dhuratë e njollosur, ose; 2.2. pala e tretë e dinte, ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorë si mjet".

[3] Neni 161, paragrafi 1 i Ligjit për Kundërvajtje (Ekzekutimi i vendimeve) përcakton se vendimi për kundërvajtjen ekzekutohet kur e merr formën e prerë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe". Kurse paragrafi 2 përcakton që "vendimi për kundërvajtje ka marrë formën e prerë kur nuk mund të atakohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesa".

[4] Bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, ku përcaktohen kompetencat e Gjykatës Supreme, në pikën 1.4 parashihet edhe kompetenca për të përcaktuar qëndrimet parimore, për të nxjerrë mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.

	3. Trajtimi i kundërshtimeve nga Komisioni për Vendosje 3.1. Në bazë të evidencave të Komisionit për Vendosje, pothuajse në të gjitha rastet kur ngasësit që ndëshkohen për shkak se hasen duke drejtuar mjetet gjatë periudhës sa janë në fuqi masat mbrojtëse "ndalim i të drejtuarit të mjetit motorik", ata shfrytëzojnë të drejtën e kundërshtimit në këtë Organ. Për faktin se konfiskimi i përkohshëm i automjeteve në bazë të nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-186 po prekë interesat edhe të palëve të treta (në këtë rast, të pronarëve të automjeteve), për ankesat lidhur me këto kundërvajtje, Komisioni është duke aplikuar shqyrtimin me prioritet të lëndëve, me qëllim të minimizimit të dëmit që mund t'u shkaktohet pronarëve të automjeteve. Meqenëse Ligji nuk ka të rregulluar në mënyrë decidive situatat e konfiskimi të përkohshëm të automjeteve kur kryesi i kundërvajtjes është pronar ose jo i mjetit, me të cilin është kryer kundërvajtja, Komisioni gjatë trajtimit të lëndëve, vendimmarrjen e bazon në dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, konkretisht në dispozitat e nenit 10 mbi zbatimin përshtatshmërisht të legjislacionit penal, nenit 31 për rregullat e përgjithshme për matjen e sanksionit kundërvajtës dhe nenit 35 që parasheh zbutjen e sanksionit kundërvajtës. Në bazë të dosjeve të kontrolluara, IPK ka vërejtur se Komisioni për Vendosje pas shqyrtimit të lëndëve me masën e konfiskimit të automjeteve, kryesisht ka pranuar pjesërisht kërkesat e ankuesve (pronarëve të automjeteve) duke liruar automjetet, ose duke e zbutur kohëzgjatjen e masës së konfiskimit të përkohshëm në kufi minimal të llojit të sanksionit. Komisioni kur aplikon dispozitat e zbutjes së sanksionit kundërvajtës, vendimet i arsyeton në rrethanat lehtësuese për shkak të kryerjes së kundërvajtjes për herë të parë me masë konfiskimi, apo mos njohurive të palëve me risitë e Ligjit. 3.2. Për periudhën nga data 03.04.2024, kur edhe ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, deri më 28.08.2024, IPK ka nxjerrë të dhëna statistikore mbi numrin e kundërvajtjeve të shqiptuara sipas nenit 246, paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit, ndaj ngasësve që drejtojnë automjetet gjatë periudhave sa janë në fuqi masat e ndalimit të drejtimit të mjetit motorik. Në bazë të të dhënave të DTR dhe Komisionit për Vendosje si Organ kundërvajtës i shkallës së dytë, pasqyrohen këta indikatorë: - Numri i kundërvajtjeve lidhur me nenin 246, paragrafi 5 dhe 6 (966 sosh), - Numri i rasteve të kundërshtuara me ankesë (727 sosh), - Përqindja e rasteve kur janë atakuar kundërvajtjet e kësaj natyre (75%), - Numri i kundërshtimeve të shqyrtuara (568 sosh), - Përqindja e kundërshtimeve të shqyrtuara (78%). - Numri i kundërshtimeve në proces të shqyrtimit (159 sosh), - Përqindja e kundërshtimeve në proces të shqyrtimit (22%).
Vlerësimi i përgjithshëm (përfundime)	Nga gjetjet e këtij inspektimi pasqyrohet se: 1.1. Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor në njërën anë parasheh konfiskimin e përkohshëm të automjetit për ngasësit që hasen duke e drejtuar mjetin gjatë periudhës sa është aktive masa mbrojtëse "ndalim i të drejtuarit të mjetit motorik", por nuk ka paraparë dispozita decidive edhe për situatat kur kryesi i kundërvajtjes nuk është pronar i mjetit me të cilin është kryer kundërvajtja. 1.2. Me gjithë faktin se Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor nuk ka të rregulluar çështjen e konfiskimit të mjetit gjatë periudhës sa është aktive masa e ndalimit të drejtimit të mjetit për jo pronarët e mjeteve me të cilat kryhen kundërvajtjet, në anën tjetër, Ligji për Kundërvajtjet parimisht parasheh këtë situatë, nëse përmbushen një varg kushtesh. 1.3. Mungesa përcaktimit të masës së konfiskimit të përkohshëm kur kryesi nuk është pronar i mjetit me të cilin është kryer kundërvajtja është duke paraqitur sfidë për Policinë ngase në të shumtën e rasteve ato përfundojnë me ankesa tek Komisioni për Vendosje.

	1.4. Si rezultat i konfiskimit të përkohshëm te mjeteve që janë pronë e personave të tretë, këtyre shpesh iu dëmtohen interesat e tyre ekonomike dhe sociale, si rezultat i mos deklarimit të kundërvajtjeve nga shoferët, me arsyetimin se mund të humbin vendet e tyre të punës. 1.5. Sfidat aktuale në zbatimin e kësaj dispozite ligjore (neni 246, paragrafi 6) tashmë janë adresuar dhe te Komisioni përkatës Parlamentar, ku ka gatishmëri për të vë theksin te ofrimi i zgjidhjeve përmes plotësimit-ndryshimit të Ligjit. 1.6. Lidhur me zbatimin e nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit që lidhet me konfiskimin e përkohshëm të automjetit janë krijuar dilema, nëse është i lejuar ky konfiskim edhe kur mjetet janë pronë e personave të tretë që mund të jenë të painformuar mbi masat paraprake ndaj ngasësve dhe nëse konfiskimi duhet të ndodhë në momentin e kundërvajtjes pa një vendim të plotfuqishëm të organit kompetent. 1.7. Lidhur me dilemat e ngritur rreth kësaj çështjeje shtrohet nevoja për të kërkuar opinion ligjor nga Gjykata Supreme e Kosovës, një udhëzues i të cilit do të lehtësonte zbatimin e drejtë të legjislacionit nga kjo fushë. 1.8. Si pasojë e mos nxjerrjes së aktit nënligjor që rregullon veprimet procedurale të organeve kundërvajtëse siç parashihet me Ligjin në fuqi, hendikepohet zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore dhe meqenëse po hyhet në fazën kritike të të kompletimit të bazës ligjore, struktura policore duhet të adresojë kërkesat e saj për të qartësuar procedurën e konfiskimit të automjeteve. 1.9. Palët e treta si pronar të automjeteve nuk kanë një mekanizëm që të informohen paraprakisht kur ngasësit e mjeteve të tyre janë nën efektin e masës së ndalimit të drejtimit të mjetit. Edhe Policia nuk aplikon praktika të tilla njoftuese, me qëllim që të minimizohen situatat që mund të pasojnë me konfiskim të mjeteve.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	**Rekomandimi**	**Niveli i prioritetit**	**Komentet e strukturës policore[5] (në origjinal)**	**Plani i veprimit**
1.	*IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Çështje Ligjore të Policisë së Kosovës, që të kërkojë nga Gjykata Supreme e Kosovës, nxjerrjen e opinionit ligjor mbi zbatimin e dispozitave të nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në lidhshmëri edhe me Ligjin për Kundërvajtje, i cili do të shërbejë edhe si udhëzues mbi mënyrën e drejtë të zbatimit të legjislacionit në fuqi sa i përket konfiskimit të përkohshëm të automjeteve.*	*-I-*	*DPSÇL-ja respektivisht Sektori për Çështje Ligjore do të kërkoj mendim juridik nga Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar ne Rekomandimin e IPK respektivisht raportin e Inspektimit ref. IPK/30092024/DI si dhe ne ankesat e qytetarëve lidhur me konfiskimin e automjeteve në trafik duke u bazuar ne Ligjin Nr. 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor.*	*TM-IV 2024*
2.	*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që përmes strukturës kompetente policore, të adresojë tek Ministria kompetente, kërkesat në vazhdën e nxjerrjes së aktit nënligjor për procedurën e kundërvajtjes, të paraparë edhe me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor (neni 257), në mënyrë që akti në fjalë të rregulloj edhe procedurën e konfiskimit të automjeteve.*		*<u>Përgjigje e dhënë nga MPB për strukturën e inspektuar:</u>* *Faleminderit për përcjelljen e rekomandimeve të dala nga inspektimi lidhur me zbatimin e nenit 246, paragrafi 6 të Ligjit 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor. Siç ju kemi njoftuar edhe në takim, për sa i përket rekomandimit mbi përfshirjen e kësaj çështjeje në Projekt Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 00/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 05/2023 për Procedurat e Kundërvajtjes, për shkak të mungesës së bazës konkrete ligjore, një gjë e tillë është e pamundur të bëhet përmes një akti nënligjor. Siç jeni në dijeni, Zyra e Kryeministrit ka shfuqizuar dhe kujdeset që të mos lejojë që të ketë në fuqi asnjë akt që nuk ka bazë konkrete ligjore. Megjithatë, rekomandimi është i vlefshëm dhe do të merret parasysh në rastin e ndryshimeve të ardhshme të legjislacionit në fushën e kundërvajtjes rrugore, pra të vet ligjit.*	
3.	*IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor dhe udhëheqësve të strukturave policore përgjegjëse për kontrollin dhe*		*Nga fillimi i hyrjes në fuqi të ligjit të ri të trafikut, Divizioni i Trafikut Rrugor ka promovuar ndryshimet në këtë ligj duke*	

[5] Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 09.10.2024, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

	sigurinë e komunikacionit rrugor që në të ardhmen të shqyrtojnë mundësitë për të filluar aplikimin e praktikave për njoftimin e personave të tretë, kur automjetet e tyre janë përdorur si mjet për kryerjen e kundërvajtjeve të trafikut, në drejtim të ndërmarrjes së hapave nga ana e tyre në parandalimin e situatave që mund të rezultojnë me konfiskimin e mjeteve të tyre.		*sensibilizuar shoferët dhe të gjitha palët që mund të preken nga zbatimi i këtij ligji përmes mediave të shkruara dhe elektronike, konferencës që është mbajtur ekskluzivisht për promovimin e hyrjes në fuqi të ligjit, përmes rrjeteve sociale të PK-së e forma tjera të njoftimit dhe sensibilizimit të pjesëmarrësve në trafik përfshirë personat fizik dhe juridik që mund të preken nga ky ligj konkretisht vëmendje i është kushtuar risive që kanë dalë nga ky ligj dhe kërkesës për zbatim nga pjesëmarrësit në trafik.* *Do të vazhdojmë me sensibilizim të pjesëmarrësve në trafik edhe në të ardhmen për respektim të dispozitave të këtij ligji si nga personat fizik dhe juridik, ndërsa rekomandimi për njoftimin e palëve të treta lidhur me vendimet për kundërvajtje që shqiptohen në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes është i pamundur si nga ana teknike ashtu edhe në aspektin ligjor respektivisht shkeljes së privatësisë për palët e treta.*	